



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 115 prot.

Tiranë, më 19. 01. 2024

V E N D I M

Nr. 23, datë 19. 01. 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, mori në shqyrtim ankesën² nr. 131, datë 22.06.2023, e Shoqatës DJ³, në cilësinë e përfaqësueses së komunitetit fetar të DJ, kundër P. V., në cilësinë e Pastorit të Kishës Evangjeliste, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *bindjeve fetare*.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: “Më 18 maj 2023, gjatë emisionit “Good Morning Albanians” në televizionin Euronews Albania, P. V. bën këto deklaratat shpifëse dhe me një gjuhë urrejtjeje kundër komunitetit tonë minoritar fetar:

P. V.: DJ nuk janë aktivë (në ekran shfaqen pamje të një statusi të bërë prej tij në vitin 2020, me titull: DJ janë një sekt satanik, anti Krisht, dhe gazetari e pyet për këtë status) Ai përgjigjet: Është e vërtetë kjo (i referohet asaj që ka shkruar në status). Unë e shikoj në këtë mënyrë për shkak se DJ janë një sekt ku ka fakte tashmë që për shkak të predikimeve të tyre njerëzit kanë shkuar deri në vetëvrasje. Dhe unë mendoj personalisht që ky është një satanizëm, mund të flasësh çfarë por nëse ti je një njeri i cili nuk i bën gjërat e qarta, nuk mund....shiko kisha apo xhamia nuk është vendi ku lehet? (nuk kuptohet domethënia) Predikimi thikë me dy presa. Duhet

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Plotësuar nga Shoqata DJ më datë 20.07.2023.

³ Në vijim referuar me akronimin Shoqata “DJ” ose DJ.

qartësuar njerëzit, dhe në qoftë se ti predikon nuk ka ferr po ka parajsë, një njeri i cili ka probleme depresive thotë 'meqë s'ka ferr unë do ja fus vetes dhe shkoj në parajsë sepse ske një vend tjetër ku të shkosh, dhe ky është predikimi i tyre (DJ), për mua është satanik për shkak se s'është e mundur që qenka Zoti s'qenka Djalli...

Gazetarja: Mund t'ju pyes pak dhe për komunitetin e DJ të gjithëve ju? Ne i kemi kontaktuar sepse donim të kishim përfaqësues të të gjitha besimeve fetare. Si është dhe marrëdhënia juaj me DJ?

P. V.: Kur unë them se është sekt satanik, është për arsye të tilla. Ata janë njerëz shumë të mbyllur, këto janë sekte...(del postimi i tij në ekran) dhe nuk pranojnë të hyjnë në debate, nuk pranojnë të jenë pjesë e tavolinave. Pra janë një sekt, që brenda tyre....ka shtete të cilat i kanë quajtur të jashtëligjshëm.

Gazetarja: DJ?

P. V.: Absolutisht po. Dhe ata janë njerëz që mbjellin urrejtje nëpër shembull, në qoftë se unë në kishën time do predikoj, ti nuk ke të drejtë, ti them besimtarit, që martohet vëllai jot e të mos i shkosh në dasmë, kjo është tmerr...nuk di....

Gazetarja: Pse ku ndodh?

P. V.: Te DJ.

Gazetarja: Po pse?

P. V.: Nuk i lejojnë as t'u shkojnë në festa familjare, as nuk u lejojnë të shkojnë të festojnë ditëlindjet. E pra janë njerëz të cilët... është ...janë kthyer...

Gazetarja: E keni të sigurt këtë? Se mund të jetë dhe ndonjë rast sporadik dhe përgjithësohet.

P. V.: Është predikimi i tyre dhe është 100% një milion % jam i sigurt. Unë e njoh shumë mirë, në qoftë se ka një sekt në Shqipëri që unë e njoh shumë mirë dhe e kam studiuar.

Gazetarja: Juve e quani sekt, vazhdoni ta quani sekt?

P. V.: Është sekt, edhe në Amerikë quhet sekt. Dhe unë... për shembull, do të them se dikush mund të thotë po ata...ti je kundër atyre se ata nuk besojnë se Jezus Krishti është Zot siç beson ti. Nuk është ky thelbi se nëse shkojmë këtu do të merresha me Mormonët, apo do të merresha me Bahai, por problemi është se është një sekt i rrezikshëm. Dhe unë mendoj shteti shqiptar duhet jo ti persekutojë por duhet ti shikojë këto grupimet që kanë hyrë në Shqipëri.

Gazetarja e pyet a nuk mund t'i përfshini edhe ata mes jush.

P. V.: Unë kam provuar dy herë, kur isha pastor në Berat kam shkuar në shërbesat e tyre kastile sepse e dija cili ishte reagimi i tyre. Gjëja e parë që kanë bërë, më kanë sulmuar, jo me emër, por kanë sulmuar publikisht besimin e krishterë...

Gazetarja e pyet se në çfarë vitesh bëhet fjalë dhe çfarë kanë thënë.

P. V.: 93-94 s'ka rëndësi çfarë kanë thënë por e kam fjalën në qoftë se...këto janë sekte të cilat shteti duhet të merret seriozisht.

Gazetarja: Po mund të kenë ndryshuar...

P. V.: Jo nuk kanë ndryshuar sepse e kanë...ata kanë K.... e R...., një revistë e cila i instruktonte ata në mënyrë të detajuar cila është mënyra e sjelljes, mënyra e jetesës dhe mënyra e sjelljes me ata që janë jashtë grupimit të tyre”.

Sakaq, Shoqata “DJ”, pretendon se: “P. V. i përshkroi DJ si një “sekt të rrezikshëm”, “satanik”, shtrembëroi bindjet dhe praktikat tona dhe shkoi deri aty sa akuzoi në mënyrë të rreme DJ për krime serioze si nxitje të vetëvrasjes dhe nxitje të urrejtjes. Komentet e tij janë plot me një gjuhë urrejtjeje, shpifëse, diskriminuese dhe shërbejnë veçse për të ushqyer urrejtje, mosbesim dhe dyshime ndaj minoritetit tonë fetar”.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve fetare nga ana e P. V.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Për sa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

.....

b) legjitimimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative.”

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitetit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t’i referohemi LMD-së, rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të shkronjës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive.

“Interesi i ligjshëm” është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimimin e saj në kryerjen e ankesës.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me nr. 6087, datë 13.08.1993, nëpërmjet së cilit Shoqata “DJ”, është regjistruar si person juridik, si dhe Statutit të saj, konstatohet se qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së kësaj shoqate është ndër të tjera të kujdeset për nevojat fetare e shpirtërore të besimtarëve DJ që jetojnë në Shqipëri dhe mbështet aktivitetin e tyre fetar të bazuar në Bibël, që është pjesë e adhurimit të tyre ndaj Perëndisë.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 6087/8, datë 19.04.2022, si dhe Statutit të Shoqatës, A. V. është zgjedhur President i Shoqatës⁴, e cili bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 11, pika 3, geramat b) dhe c), të Statutit, ka tagrin e përfaqësimit të Shoqatës në marrëdhënie me institucione të ndryshme (shtetërore apo private) dhe me persona të tretë.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët janë e ndjehen pjesë e grupeve të mbrojtura nga kjo Shoqatë. Mbështetur në objektin e veprimtarisë së Shoqatës, sipërcituar në vendim, Komisioneri gjykon se Shoqata, përfaqësuar nga A. V. (President i Shoqatës) legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të saj dhe komunitetit fetar që ajo përfaqëson.

Për sa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndjekur të gjithë hapat e parashikuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

1. Me shkresën nr. 772/2 prot., datë 26.07.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e P. V. dhe Televizionit Euronews Albania, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Shoqëria “Euro Balkans News” sh.p.k., me shkresën⁵ datë 02.08.2023, informoi ndër të tjera se: “*Subjekti Euronews Albania është franchising direkt i “Euro News” S.A në Lyon Francë dhe zbaton me përpikmëri politikën e tij editoriale të pavaruara, Kartën Editoriale të Euro News, Kodin e Etikës dhe Kodin e Sjelljes, si dhe ushtron veprimtarinë e saj në respektim të plotë të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.*

Në kuadër të misionit që ka media, lidhur ngushtësisht me lirinë e shprehjes, të drejtën për informim dhe për të ditur, si një marrëdhënie e ngushtë besimi e krijuar me marrësin e informacionit, temat e përzgjedhura për t’u trajtuar në emision kanë si qëllim të përcjellin informacion me interes për publikun.

Në kushtet kur në adresë të emisionit “Good Morning Albanians”, të transmetuar në datë 18 Maj 2023 është bërë një ankesë pranë Institucionit tuaj, dëshirojmë të ravijëzojmë se televizioni nuk ka patur për qëllim të nxisë provokime apo sjellje të papërshtatshme, të cilat prekin direkt apo indirekt apo dalin kundër një feje të caktuar, apo të diskriminojë direkt apo indirekt një person apo grup personash, për shkak të bindjeve dhe qëndrimeve të tyre fetare.

Tema e kësaj dite ka patur në qendër diskutimin për mbështetjen që shteti i’u jep institucioneve të ndryshme fetare në Republikën e Shqipërisë që nga mbështetja financiare e deri

⁴ Me një mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, referuar nenit 11, pika 2 e Statutit të Shoqatës.

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 902 prot., datë 03.08.2023

tek ajo institucionale, kjo në vijim edhe të raportit të DASH (Departamenti Amerikan i Shtetit) për lirinë fetare në Shqipëri. Duke konsideruar faktin se shoqata “DJ në Shqipëri” citohej në raportin e DASH, ftesën i’a kemi dërguar fillimisht përfaqësuesve të kësaj shoqate dhe më pas edhe përfaqësuesve të besimeve të tjera fetare, kjo e provuar edhe nëpërmjet komunikimeve zyrtare që kemi patur jo vetëm me D. M. nga kjo shoqatë, por edhe me të ftuarit e tjerë. Konkretisht, me P. V. kemi komunikuar në telefon, ndërsa me Y. G. nga Komuniteti Mysliman dhe me G. P. (kisha Orthodhokse) kemi komunikuar nëpërmjet mesazheve.

Përsa më sipër, si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 10221/2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ... për rastin në fjalë mund të deduktojmë se nuk ka patur asnjë diskriminim midis palëve të cilat gjenden në situatë të njëjtë apo të ngjashme, duke kuptuar përfaqësuesit e besimeve fetare në Shqipëri, të cilët duke u gjendur në një situatë të ngjashme janë njoftuar rregullisht për pjesëmarrjen në emisionin e mëngjesit për të folur rreth temës si dhe qëndrimeve të tyre, pra nuk ka patur asnjë trajtim të padrejtë, jo të barabartë dhe të diferencuar për ndonjërin prej përfaqësuesve të besimeve fetare, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte. Të gjithë të ftuarit janë trajtuar në të njëjtën mënyrë, madje përsa si përket të ftuarve në studio secili ka patur kohë televizive të njëjtë për t’u shprehur.

Konkretisht nga shoqata “DJ në Shqipëri” kemi komunikuar me D. M., i cili në lidhje me këtë ftesë n’a ka informuar se nuk dëshironin të merrnin pjesë në emision, por megjithatë duke e konsideruar si një komunitet fetar në Shqipëri si dhe për individët të cilët janë pjesë e tij, kemi informuar publikun për arsyet e mos prezencës në televizion ku moderatorja e emisionit znj. G. T., ka lexuar për publikun mesazhin e dërguar nga D. M., konkretisht në 15’23” (në minutën e 15, sekondi 23), e provuar kjo edhe nga regjistrimi i emisionit i depozituar si provë në CD bashkëlidhur kësaj shkrese.

Kurrsesi nuk ka qenë qëllimi i televizionit që të nxisë urrejtje, të përhapë informacione të rreme apo të diskriminojë një grup të caktuar.

Sjellim në vëmendje të Komisionerit për Mbrotjtjen nga Diskriminimi se shoqata “DJ në Shqipëri” ka paraqitur ankesë edhe pranë Autoriteti i Mediave Audiovizive (këtu e në vijim referuar si AMA) me Nr. 2402 prot., datë 22.06.2023, e cila pavarësisht faktit se ka qenë tej afateve ligjore për paraqitjen e ankesës duke konsideruar ndjeshmërinë që kjo temë paraqet, AMA e ka marrë në shqyrtim si dhe ka kërkuar informacionin e nevojshëm nga Euronews Albania, i cili i është vendosur në dispozicion me shkresën Nr. 2402/2 prot., datë 12.07.2023.

Euronews Albania, sapo ka marrë dijeni për ankesën e ardhur ka marrë të gjitha masat për t’a adresuar atë, duke komunikuar fillimisht me D. M. në rrugë telefonike e në vijim nëpërmjet adresës elektronike konkretisht me e-mail e datës 07.07.2023, për t’u përpjekur për të kuptuar situatën si dhe gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët. Televizioni e ka ftuar D. M. përsëri për të shprehur në emision qëndrimin e tij, por ky i fundit ka refuzuar duke na komunikuar në rrugë telefonike që nuk ka asnjë pretendim nga televizioni por ndaj qëndrimeve personale të të ftuarit, ndërkohë përsa i përket e-mail të dërguar në formë zyrtare nuk ka kthyer ende një përgjigje. Pra edhe në këtë rast, televizioni ka vepruar në mënyrë aktive për t’i dhënë kohën e duhur televizive duke siguruar lirinë e shprehjes dhe qëndrimeve në përputhje me kuadrin rregullator në R.Sh-së.

Ankesa e ngritur nga shoqata “DJ në Shqipëri” pranë AMA-s i referohet komenteve personale të njërit prej të ftuarve në emision P. V., ku vlen të theksojmë se është tërësisht

qëndrimi i tij personal dhe televizioni nuk atashohet në asnjë moment me këtë qëndrim dhe nuk ka asnjë përgjegjësi përsa P. V. është shprehur. Ne si televizion nuk atashohemi me mendimin e të ftuarve dhe kjo del qartë edhe nga biseda në studio ku moderatorja e ka pyetur konkretisht nëse “ka siguri për akuzat që po bën”, apo se “ku ka ndodhur” konkretisht ngjarja të cilës i ftuari i referohet. Megjithatë në asnjë moment nuk është aprovuar nga televizioni qasja personale që P. V. ka, por qëllimi i vetëm ka qenë kryerja e misionit që televizioni ka për të qartësuar dhe informuar publikun dhe jo të nxis diskriminimin. Kjo gjetje është paraqitur edhe në vendimarrjen e AMA-s, konkretisht në shkresën Nr. 2645 prot., datë 24.07.2023, të cilën e gjeni bashkëlidhur kësaj kërkesë.

Në këtë kuadër, televizioni Euronews Albania ka marrë të gjitha masat për t’a zgjidhur çështjen me mirëkuptim duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues të shoqatës, duke i’u kthyer përgjigje çdo pyetje të tyre si dhe duke i’u ofruar kohë televizive për të shprehur qëndrimet dhe shqetësimet e tyre. Duke qenë se televizioni Euronews Albania, ka mbajtur kontakt e komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues të shoqatës, është konsideruar nga ana jonë e ezauruar procesi i kthimit të përgjigjes.

Gjithsesi, Euronews Albania është e hapur për të diskutuar me Institucionin tuaj dhe për të ndërmarrë të gjitha hapat që transmetimi të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, edhe pse besojmë që Euronews Albania ka ndërmarrë çdo hap për të realizuar funksionin e saj si një media e lirë, e pavarur dhe e paanshme”.

Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, P. V. përmes shkresës protokolluar pranë KMD-s me nr. 912 prot., datë 04.08.2023, informoi ndër të tjera se: “...E lexova letrën tuaj me shumë kujdes dhe në mënyrë të përmbledhur do të rendis arsyet përse “praktikat sektare” të DJ⁶ janë të dëmshme për jetën shpirtërore të një besimtarit. Që prej fillimit të viteve 1990, kur shteti shqiptar lejoi dhe ligjëroi lirinë e së drejtës së besimit, të krishterët ungjillorë, besim të cilin unë predikoj dhe i kam dedikuar jetën time, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në çdo qytet, fshat dhe rrethinë të vendit tonë dhe jo më kot ai u ligjërua si një nga 5 komunitetet zyrtare fetare në Republikën e Shqipërisë.

Z. Komisioner, si Pastor, që nga 17 Shkurti i vitit 1992, gjatë gjithë jetës sime si shërbëtor i Perëndisë dhe i njerëzve në nevojë, kam kërkuar të udhëhiqem nga dashuria, hiri dhe mëshira për njerëzit, pa dallim race, feje apo ideje.

U jam përkushtuar njerëzve në nevojë e sidomos jetimëve socialë, së bashku me bashkëshorten time për 29 vite me rradhë. Për këtë shkak, Presidenti i Republikës na ka dekoruar me urdhërin “Nënë Tereza”. Gjatë rrugëtimit tim 31 vjeçar në shërbesë, jam burgosur nga sigurimi i shtetit, jam rrahur e disa herë, sharë e kërcënuar me jetë, por isha dhe jam i bindur që kjo është ajo barrë që do të duhej ta mbaja dhe që shumë herë njerëzit nuk do të ishin dakord me besimin tim. Si njeri shpirtëror dhe i besimit, studimi dhe të jetuarit sipas një doktrine të shëndoshë është prioritet i jetës time. Mbrojtja dhe këshillimi i besimtarëve të komunitetit tonë nga doktrina fallco apo të gabuara është një faktor shumë i rëndësishëm për mua si Pastor.

⁶ I referohet me akronim shoqatës “DJ në Shqipëri”.

I ftuar në TV “Euro News Albania” jam pyetur për të folur në lidhje me raportin e Departamentit të Shtetit për liritë dhe harmoninë fetare. Gjatë emisionit më është kërkuar gjithashtu një koment mbi një status të para 3 viteve, publikuar nga unë në aplikacionin Facebook në të cilin unë isha shprehur se DJ janë një sekt satanik. Nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do jetë kurrë qëllim i imi, lufta kundër këtij sekti, edhe pse jam ftuar të flas për këtë grupim në TV e kam refuzuar, sepse besoj që nuk jam thirrur në jetën time të bëj luftë kundër asnjë feje, besimi, sekti apo grupimi tjetër shoqëror. Pra, ky ka qenë vetëm një episod. Ju përgjigja pyetjeve të gazetarëve se cila ishte arsyeja që kisha vendosur një status të tillë në vitin 2020. Në pamundësi për të folur gjatë e për të shpjeguar veten, brenda një minutazhi të kufizuar televiziv, lejomëni tu them se argumenti që qëndron pas statusit tim në Facebook është dhe mbetet një: refuzimi i prerë që bëhet nga DJ, i transfuzionit të gjakut dhe pasojat fatale që çon ky privim për jetën. Më poshtë unë do të paraqes disa prej këtyre argumentave. Unë u qëndroj të gjitha deklaratave të mia. Në emision është e vërtetë që kam thënë gjithashtu që praktikat sektare të kryera prej DJ, kanë çuar njerëzit deri në vetëvrasje.

Liria e së drejtës së ushtrimit të besimit hapi dyert për shumë rryma, sekte apo grupime të ndryshme, për disa prej të cilave unë kam rezervat e mia duke dashur më shumë monitorim për brendinë e doktrinave që përcjellin dhe ushtrimin e tyre.

- Skti i DJ predikon ndalimin e transfuzionit të gjakut.

Jo pak herë, për shkak të këtyre praktikave, familjet kanë vendosur në rrezik jetën e fëmijëve apo familjarëve të tyre duke shkuar deri në humbjen e jetës për një bindje të tillë.

Në disa prej vendeve demokratike, u është hequr e drejta e kujdestarisë familjeve të cilat kanë refuzuar transfuzionin e gjakut për fëmijën e tyre.

DJ janë themeluar nga K. R. në fillimin e shekullit të 19-të.

Shkenca mjekësore gjatë luftës së parë botërore zbuloi se transfuzioni i gjakut shëronte jetën e ushtarëve të plagosur dhe parandalonte vdekshmërinë duke qenë kështu që në fillimet e viteve 1914 e këtej një ndër mrekullitë që shkenca mjekësore ka zbuluar.

DJ e refuzojnë në mënyrë fanatike një procedurë të tillë nga një individ në çfarëdo lloj situatë apo rrethane qofshin, duke shkaktuar në këtë formë rritjen e rriskut për vdekshmëri. Të indoktrinuar nga këto mësimet të DJ dhe refuzimi haptazi i transfuzionit të gjakut, jo pak herë shifrat kanë qenë alarmante, duke refuzuar me vetëdije jetën e duke pranuar vdekjen, si shenjë e një niveli të lartë dedikimi nga ndjekësit e tyre.

A nuk është kjo satanike?

Ndër shumë e shumë dëshmime të bëra publike nga media të ndryshme ndërkombëtare, lejomëni të sjell në vëmendjen tuaj vetëm dy shembuj flagrantë.

- Në vitin 2007 gazeta prestigjioze “The Guardian”, shkruan për rastin e një nëne 22 vjeçare me emrin Emma Gough, e cila pas lindjes së dy binjakëve humbi shumë gjak dhe kishte nevojë për transfuzion gjaku, por për shkak se ajo ishte një praktikante e DJ, ajo refuzoi transfuzionin, duke kaluar kështu në vetëvrasje dhe duke lënë dy foshnja të sapolindura jetim.

A nuk është satanike një gjë e tillë zoti Komisioner?!

Natyrshëm më lind pyetja: Nëse kjo grua, kjo nënë, apo shumë të tjerë nën efektin e të njëjtave “praktika besimi” nuk do të kishte qënë pjesë apo ndjekëse e DJ, a do të refuzonte ajo vallë transfuzionin e gjakut në të cilën është jeta?

A do të përqafoje ajo me vetëdije vdekjen duke lënë dy fëmijë jetim? Unë besoj Jo!

- Rasti i dytë është rasti i një djaloshi 14 vjeçar, praktikant i sektit DJ, me emrin Dennis Lindberg, i cili kaloi në vetëvrasje duke refuzuar transfuzionin e gjakut, shkrim ky, botuar në “Nbc news”. Dennis vdiq me 28 Nëntor 2007 dhe Nbc news e njoftoi vdekjen e tij me 30 Nëntor 2007 në artikullin e orës 14.00. Dennis kishte 75% shanse për të jetuar nqs do të bënte transfuzion gjaku. Gjykatësi që gjykoi çështjen e Dennis tha: “Dennis i dha vetes dënimin me vdekje (pra vetvrasje)”.

Zoti Komisioner, Emma dhe Dennis nuk lindën DJ, dhe besoj do jetonin nëse nuk do ishin pjesë e këtij grupimi.

A nuk është kjo satanike dhe nga bota e errësirës?!

Refuzimi me vetëdije i jetës dhe përqaftimi i vdekjes reale, nën petkun e një “bindjeje të përkushtuar” për shkak të praktikave dhe mësimëve nga ky sekt, duke përfshirë çdo gjini apo moshë, në çdo rrethanë të mundshme, duhet kundërshtuar dhe refuzuar hapur dhe nëse unë kam një zë i cili dëgjohet, unë do ta ngre zërin që të ruhet grigja e Zotit.

Bibla, Fjala e Shenjtë është udhërrëfyese im; si Pastor dhe predikues i kësaj Fjale, unë kam përgjegjësinë dhe vajosjen të këshilloj besimtarët apo çdo individ që kërkon Zotin. Më lejoni të citoj dy vargje nga Bibla:

Gjoni 10:10, nga Fjala e Shenjtë thuhet:

“Vjedhësi nuk vjen veçse për të vjedhur dhe për të vlarë e për të shkatërruar; Unë (Krishti) kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk”.

dhe tjetri:

Titi 3:10(a)

“Refuzoje një njeri sektar”...

*Besimi i shëndoshë i krishterë predikon dashuri për jetën që ta fal Zoti dhe dashuri për të afërmin.

*Besimi i shëndoshë i krishterë paralajmëron besimtarin të bëjë kujdes nga çdo mësuës apo mësim të rreme, të cilat në mënyrë djallëzore të vjedhin jetën.

I nderuar z. Komisioner, unë jam Pro Jetës dhe besoj që edhe ju jeni pro jetës. Nuk do të heq dorë derisa të kem frymë, duke shpallur shpresën e vërtetë dhe jetën me bollëk që vjen përmes Krishtit. Komuniteti Ungjillor i Krishterë, shumë herë ka bërë thirrje të hapura dhe ka krijuar organizime masive për dhënien e gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemik.

Vetëm brenda vitit 2022, sipas Shoqatës së Talasemikëve, rezultojnë mbi 500 fëmijë me nevoja konstante e të rregullt për gjak. Madje, ne jemi vendi me nivelin me të ulët të dhurimit të gjakut, vetëm 0.5% e nevojave imediate.

Imagjinoni ju lutem, sikur të gjithë këta fëmijë do të ishin pjesë e DJ dhe do të ishte një refuzim masiv i kryerjes së transfuzionit të gjakut. Imagjinoni z. Komisioner se cilat do të ishin pasojat?!!

Unë jam i sigurtë që askush nga ne nuk do të mund të qëndronte indiferent dhe pa reaguuar përpara një fakti të tillë.

A do të guxonte qoftë edhe një përfaqësues nga DJ të mbrojë hapur që edhe ata, qoftë një herë të vetme, kanë kontribuar në këtë formë apo forma të ngjashme humanitare?...

DJ nuk mohojnë vërtetësinë e argumenteve të mi, por pretendojnë që gjuha ime mbjell urrejtje.

Në kaq vite jetë të dedikuar dhe përkushtuar Krishtit, gjuha ime është vetëm ajo e dashurisë dhe vëllazërisë.

Nuk ju kam mohuar të drejtën e zgjedhjes së askujt, dhe sa të jem gjallë nuk do e bëj një gjë të tillë por kam identifikuar që jo çdo zgjedhje që dëmtoj jetën me qëllim pavarësisht nga kush e si, nuk është zgjedhja e duhur, si në rastin e të qenit pjesë e këtij grupimi, që sipas mendimit tim është një sekt, dhe praktikimi i refuzimit të transfuzionit të gjakut është një vetvrasje. Qëllimi im nuk është të flas për sekte, por të përcjell dashurinë e Krishtit tek njerëzit. Ata asnjëherë nuk pranojnë një ballafaqim publik për gjëra të tilla, sepse janë pjesë e trushpëlarjes që u bëjnë njerëzve gradualisht dhe janë të pakënaqur që këto gjëra të thuhet publikisht.

Si një person publik dhe duke besuar se ajo që ka vlerë të patjetërsueshme është jeta, jam i gatshëm për një dëgjuesë publike nëse e shihni të arsyeshme një gje të tillë.”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 772/3 prot., datë 26.09.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, pranë Zyrës së Komisionerit.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 19.10.2023, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e përfaqësuesve të palës ankuese: P. D. dhe E. Z., përfaqësues me autorizim⁷ të Shoqatës “DJ në Shqipëri”, si dhe të palëve kundër të cilës është paraqitur ankesa: P. V., personalisht dhe përfaqësuesve të Euronews Albania, Xh. S dhe A. K⁸.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Në deklaratimet e bëra gjatë seancës, palët mbajtën të njëjtin qëndrim, si ai i komunikuar shkresërisht Komisionerit.

Nga ana e përfaqësuesve të DJ, u theksua ndër të tjera se: “...Gjatë emisionit “Good Morning Albanians” në televizion Euronews, zoti P. V. bëri deklaratë shpifëse dhe përdori një gjuhë urrejtje kundër komunitetit tonë minoritar fetar. Zoti P. V. tha se DJ nuk janë aktivë dhe në ekran shfaqet pamja e një statusi të bërë prej tij në vitin 2020 me titull “DJ” janë një sekt satanik antikrisht”... Kjo është një gjë që nuk mund të tolerohet në një gjuhë të tillë në media publike nga një përfaqësues i një komuniteti fetar. Prandaj, Zoti P. V. i ka përshkruar DJ me komentet e tij, si një sekt të rrezikshëm satanik... Shkoi deri aty sa na akuzoi në mënyrë të rreme për krime serioze, si nxitja e vetëvrasjes dhe nxitja e urrejtjes. Komentet e tij janë plot me gjuhë urrejtje, shpifëse,

⁷ Sipas Autorizimit me datë 19.10.2023, të Shoqatës “DJ në Shqipëri”.

⁸ Sipas Autorizimit me datë 18.10.2023, të Euronews Balkans shpk.

diskriminuese dhe shërbejnë për të ushqyer opinionin publik me urrejtje, mosbesim dhe dyshim ndaj komunitetit tonë fetar... Duam të theksojmë që nuk është hera e parë që zoti P. V. përdor një gjuhë të tillë urrejtje. Ai na ka lidhur edhe me rastin e Kombinatit dhe ka përsëritur një gjuhë të tillë kundër nesh në vazhdimësi. Për dallim nga zoti P. V. që përdor citime nga gazetatat, ne kemi një vendim gjykate, i cili tregon, që vetë e mbijetuara e rastit të kombinatit thotë që është pjesë e Kishës Ungjillore dhe askund nuk përmendet fakti që ato kanë të bëjnë me DJ...”.

P. V., ndër të tjera, mbajti qëndrimin se⁹:

“...Deklarata ime nuk ka të bëjë me njerëzit që e ushtrojnë besimin e DJ... Në mënyrë absolute, unë nuk e mendoj veten time që unë mund të jem një njeri që po shkakton urrejtje kundër një grupi shqiptar. Unë kam një problem, dhe problemi im është me praktikatat. Unë i kam quajtur "sektare". Unë nuk di një fjalë tjetër që në gjuhën shqipe mund të krahasoj praktikatat... Kam sjellë dy fakte të cilat janë në mbarë botën të njohura, por në qoftë se ne hyjmë dhe lexojmë, shohim se sa shumë njerëz praktikantë të DJ kanë çuar veten e tyre në vetëvrasje. Unë e quaj vetëvrasje për shkak se nëse ti ke një mundësi që shkenca mjekësore të ofron për jetën dhe ti e refuzon duke pranuar vdekjen, personalisht, unë e quaj vetëvrasje. Kur kam thënë këtë gjë, kam patur parasysh për sa i përket transfuzionit të gjakut...Unë besoj personalisht që një sjellje e tillë, një praktikë e tillë, unë nuk di një emër tjetër përveçse një praktikë satanike. Unë e quaj vetëvrasje për shkak se edhe në atë letrën që unë ju kam sjellë, vetë gjykatësi për një djalë 14 vjeç tha: "Ndjej shumë dhimbje që ky djalë dënon veten me vdekje. Pra, flijimi i jetës për mua është absolutisht një akt satanik dhe kjo nuk ka lidhje me njerëzit, nuk ka lidhje me as edhe një... Jam një njeri që jam pro jetës dhe unë jam thirrur nga Zoti, që aty ku shoh që jeta e njeriut padrejtësisht preket, flijohet kur është e mundur që jeta të vazhdojë, unë e quaj vetë dhe do e quaj tërë jetën si një akt satanik. Ndaç kur dikush vret veten me pistoletë, ndaç kur dikush refuzon transfuzionin e gjakut, për mua, është e barabartë...Vazhdoj duke këmbëngulur, nuk kam asgjë me njerëzit që ushtrojnë. Unë këmbëngul në praktikën e cila ka të bëjë me dhurimin dhe refuzimin e dhurimit...”

...Më është bërë një pyetje specifike për një status që kam dhënë, dhe unë kam dhënë opinionin tim sipas bindjes time. Dhe unë i qëndroj bindjes që, praktikatat e tilla janë satanike...Pastaj, mua m'u bë specifik për DJ, po mund të bëhej edhe për një fe tjetër, nëse unë do të dija për një praktikë tjetër që vendoste në rrezik jetën, për shembull, po marr një shembull, nëse dikush do të më thotë se si mendon ti për njerëzit të cilët bëjnë vetëvrasje me dinamit në emër të një Zoti. Ç'mund të them? Nuk mund të them që është një akt satanik? Është akt satanik për mua personalisht. Unë jam një njeri i cili, thashë në mënyrë specifike, nuk kam shkuar me qëllim...

...Nuk e kam bërë thjesht dhe nuk do ta bëj sepse nuk kam asnjë lloj qëllimi të dal publikisht. Unë nuk kam nevojë as të përdor rrjetet sociale kundër një feje. Unë jam një njeri që kam besimin tim, dhe nëse besimin tim njerëzit e përkrahin, e pëlqejnë dhe besojnë, unë e kam kryer misionin...unë besoj se në këtë botë kam ardhur me një mision, misioni im është mbrojtja e jetës, nuk bëj kompromis. Unë jam i gatshëm të them kushdo që, cenon jetën, është një akt satanik dhe nuk ka rëndësi cila fe është... Ju kërkoi shumë ndjesë çuna, nuk e kam me ju personalisht. Unë jam

⁹ Referuar deklaratimeve (procesverbalit) gjatë kësaj seance dëgjimore.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

ndërkombëtar në Komunitetin Ungjillor...DJ i njoh me themel. Di si ka filluar, di çdo gjë. Dhe unë di që në qëndrimet e mia, si pastor, nuk flas kurrë kundër një feje, kurrë kundër një sekt. Pse? Sepse jam një njeri i cili nuk kam dalë të jem kundra dikujt. Unë jam pro, nuk jam kundra. Unë jam pro dashurisë, unë jam pro jetës... Po, është shumë e vërtetë. Ne duhet të kemi shumë kujdes, sepse mund të ngremë dallgë të cilat nuk duhet, kundër një feje apo një sekt. Për këtë jam shumë dakord dhe unë ju them do jemi kujdesshëm tani e tutje, sinqerisht...”.

3. Në vijim të seancës, nëpërmjet shkresës¹⁰ datë 19.10.2023, P. V. kërkoi nga Komisioneri t'i vihet në dispozicion një kopje e audio-s së seancës dëgjimore të zhvilluar po në këtë datë.

Në përgjigje të kërkesës së P. V., përmes shkresës nr. 772/5 prot., datë 24.10.2023, Komisioneri i vuri në dispozicion një kopje të audio-s (në CD) të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 19.10.2023

4. Përmes e-mail-it datë 08.11.2023, P. V. dërgoi parashtrime shtesë pas seancës dëgjimore, duke theksuar ndër të tjera se:

“Në pretendimin e DJ¹¹ për personin tim, të përdorimit të një gjuhe diskriminuese ndaj pakicave apo mbjellje e një gjuhe urrejtjeje për ta, në videon e postuar nga “Euro News Albania”, unë vetëm kam shprehur mendimin dhe qëndrimin tim në një shtet demokratik, në të cilin lejohet e drejta e fjalës së lirë, pa cenuar apo dhunuar të drejtën e tjetrit. Çdo njeri ka të drejtën legjitime të bëjë zgjedhjen e tij duke e konsideruar këshillën time për të bërë kujdes ndaj praktikave të DJ dhe jo vetëm ndaj tyre, por ndaj çdo grupimi sektar apo religjioz që hyn në Shqipëri, apo ta injorojë atë. Çdo njeri ka lirinë të dakordësohet me mua dhe të bëjë zgjedhjen e tij ose ta braktisë atë. Në diversitetin e mendimit dhe të zgjedhjeve, njerëzit janë të lirë të vendosin.

Gjatë seancës dëgjimore DJ nuk kanë parashtruar asnjë fakt konkret në lidhje me pretendimin e tyre se mënyra ime e të shprehurit në videon e postuar nga Euro News TV mbjell urrejtje apo diskriminon sektin e tyre. Natyrshëm lind pyetja se mbi çfarë bazash është ngritur ky pretendim nga DJ për personin tim? Mbi çfarë statistikash është bërë ky vlerësim i tyre? Në asnjë moment në këtë seancë DJ nuk kanë paraqitur gjëra konkrete në mënyrë që të faktojnë pretendimin e ngritur kundër meje, por vetëm mbi baza të pabaza “komentesh kafeje” prej tyre apo pakënaqësie të krijuar. Mbi çfarë bazash qëndron pretendimi i DJ, se këshilla ime njerëzve në komunitet ka përmbajtje urrejtjeje? A duhet vallë të themi që sa herë dikush këshillon, udhëzon apo flet ato gjëra që janë të ndryshme nga doktrina, këndvështrimi apo zgjedhja e dikujt tjetër, ajo është diskriminim i njëjës apo shumë palëve të tjera, në një kohë kur secili ka lirinë të zgjedhë, por pa ju cenuar jeta?

Kam kërkuar falje për shprehjen “Njerëzit e DJ janë”, pa dashur të ofendoj apo lëndoj besimtarë të cilët vërtetë aspirojnë apo janë në kërkim të së vërtetës së besimit të tyre dhe janë përfshirë në praktikën e DJ.

¹⁰ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 772/4 prot., datë 19.10.2023.

¹¹ P. V. ti i referohet me këtë akronim DJ.

Jam injoruar dhe përqeshur prej DJ në seancën dëgjimore për rastet e sjella nga unë të vdekjes së 22-vjeçares dhe 14 vjeçarit shqiptar duke u komentuar ato si “artikuj gazetash” pa dhënë asnjë argument tjetër.

Në ligjëratën e tyre, DJ janë shprehur për vendimin e Gjykatës Evropiane në të drejtën e çdo individi për ta pranuar apo refuzuar një mjekim, si një “mënyrë perfide”, kjo për të më argumentuar qëndrimin e tyre kundër transfuzionit të gjakut. Dëshiroj të theksoj se unë i besoj një shteti të së drejtës, ku respektohet liria e individit, por kam reaguar dhe do të ngre zërin tim kur individit i bëhet një thirrje apo i “predikohet” nga një grupim apo një ideologji nga jashtë tij që “predikon” ndalimin e transfuzionit të gjakut apo ndalimin e jetës si një “dedikim besimi apo besnikërie” Zotit. Unë e ndjej përgjegjësi për besimin që ndjek, që të mos hesht, por të flas hapur me njerëzit edhe kur ky qëndrim i imi sjell reagim apo paretat për DJ, sikurse edhe e kam bërë për dekada të tëra në thirrjen time si Pastor, pa mbjellë urrejtje apo diskriminuar askënd.

Në seancën e dëgjësës, DJ janë shmangur dhënies së fakteve apo argumenteve në lidhje me këtë çështje kaq delikate dhe jetike për njeriun duke u fokusuar vetëm në tonin e zërit apo qëndrimin tim duke më diskriminuar apo etiketuar madje si mashtrues.

I janë shmangur ftesës sime për bisedë apo komunikim në rrafsh njerëzor apo humanë, me pretendimin e mospasjes kohë. I janë shmangur dhe kanë refuzuar ftesën nga gazetarët e Euro News Albania për një dëgjësë publike me mua.

Zoti Komisioner, siç e patë edhe ju në dëgjësën publike, qëllimi im nuk ishte dhe nuk është diskriminimi i pakicave fetare apo mbjellja e një gjuhe urrejtjeje ndaj praktikantëve të DJ apo kujtdo grupimi tjetër në një shtet të së drejtës së fjalës apo praktikave fetare të besimit.

Për këtë të drejtë unë kam vendosur shumë herë jetën time në rrezik këtu në Shqipëri, Mongoli, Kinë, Indi, Rusi, Indonezi, Laos, Pakistan apo Vietnam, e shumë vende të tjera.

Praktikantët e DJ, përkundrazi unë i quajta dhe i quaj vëllezërit e mi, sepse shumë prej tyre tashmë janë larguar nga ky grupim nëpërmjet shpalljes së të vërtetës së Ungjillit të Krishtit që unë kam predikuar dhe predikoj.

Në përmbledhje të kësaj letre do të doja të shpreh edhe një herë qëndrimin tim si Pastor apo Predikues, si njeri i kujdesit të mirëqenies shpirtërore se jam dhe do të jem Pro Jetës, Pro Besimit, Pro Vëllazërisë, si një vlerë e trashëguar e mbarë shqiptarisë, të cilën, për sa të kem frymë, unë dua ta ushqej me të vetmen dashuri që njoh, dashurinë e Krishtit.”

III. Legjislacioni i zbatueshëm.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë bazat e shtetit të së drejtës. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cenojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cenimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t'i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët. (Neni 3, i Kushtetutës së Shqipërisë)

Liria e fjalës dhe e shprehjes konsiston në një të drejtë themelore të njeriut. Kjo e drejtë luan rol thelbësor edhe në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut. Koncepti i qytetarisë dhe i pluralizmit janë të porealizueshëm, nëse individëve nuk u jepet mundësia e shprehjes së lirë të mendimit. Toleranca ndaj mendimit të tjetrit dhe të ndryshmit, mundëson bashkekzistencën në shoqëritë bashkëkohore multikulturore.

Pavarësisht sa më sipër, liria e shprehjes mund të keqpërdoret në situata të caktuara, duke sjellë si pasojë shkeljen e të drejtave të personave të tjerë. Në emër të “lirisë së shprehjes”, individë dhe grupe të caktuara mund të shprehin ide për superioritet të një race, feje apo etnie të caktuar, me qëllim përçmimin e të gjithë atyre, që nuk i takojnë grupit “të tyre”, si dhe të bëjnë thirrje për ndjekje, izolim, po madje edhe deri për gjenocid ndaj tyre. Në raste të tilla, liria e shprehjes përbën shqetësim për kategori të caktuara individësh dhe shpesh kalon deri në gjuhë urrejtjeje ndaj tyre. Pikërisht, fenomene të tilla aktualizojnë diskutimin për lirinë e shprehjes, kufizimet e saj dhe keqpërdorimin e kësaj lirie.

Në mediat shqiptare, jo në pak raste, është konstatuar se kultura e fjalës së përdorur nuk është e duhura. Njëkohësisht, është vënë re jo në pak raste jemi ndeshur me fenomenin e nxitjes, përdorimit dhe përhapjes së “gjuhës së urrejtjes” në publik për kategori apo grupe shoqërore, pa reflektuar asnjë ndjenjë përgjegjësie për fjalën e thënë në median e shkruar dhe atë televizive.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se liria e shprehjes, toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore është thelbësore për një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Lufta kundër intolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, qëndrojnë në themel të shtetit tonë. Kushtetuta, sanksionon detyrimin e shtetit, jo vetëm të mos i cenojë ato, por të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të siguruar mos cenimin, për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe standardet minimale të saj rezultojnë të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t’i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjisllacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkelura.

Në nenin 18, të saj, Kushtetuta sanksionon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Barazia dhe mosdiskriminimi janë gur themeli edhe e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë, duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹² ku parashikohet shprehimisht: “*Liria e shprehjes është e garantuar*”. Megjithatë, Komisioneri thekson sërish faktin se liria e shprehjes dhe mendimit nuk është një e drejtë e pakufizuar dhe se ajo nuk duhet të ushtrohet në një mënyrë të papajtueshme me të drejtat e të tjerëve.

Në bazë të nenit 17, Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Parashikimi i saj sqaron se: “*Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” Në këtë kontekst, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkalar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka përcaktuar sa më poshtë vijon në nenet respektive:

Në nenin 9, “*Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë*”, citohet se: “*1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.*”

Në nenin 14, ku parashikohet “*Ndalimi i diskriminimit*”, citohet se: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*”

Neni 17, “*Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave*”: “*Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.*”

Protokolli Nr. 12, në nenin 1 “*Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit*”, citon: “*1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës*

¹² Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “*Liria e shprehjes është e garantuar*”;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”

Në Nenin 18 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966, parashikohet se:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të patuar apo adoptuar një fe apo besim të zgjedhjes personale, dhe lirinë, qoftë individualisht apo në kolektiv me të tjerë, dhe në publik apo privatisht, për të manifestuar fenë apo besimin e tij/saj në kulte, rite, praktikë e mësim.

2. Askush nuk i nënshtrohet forcës që mund të dëmtojë lirinë e tij për të patur apo adoptuar një fe apo besim sipas zgjedhjes së tij.

3. Liria për të manifestuar fenë apo besimin fetar do t'i nënshtrohet vetëm kufizimeve të parashikuara me ligj e që janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin, shëndetin apo moralin, apo të drejtat themelore e liritë e të tjerëve.

4. Shtetet Palë të kësaj Konvente angazhohen që të respektojnë lirinë e prindërve, dhe kur është e nevojshme, të kujdestarëve ligjorë, për të siguruar edukimin fetar e moral të fëmijëve të tyre në përputhje me vetë bindjet e tyre.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, referon në nenin 2 se: *“1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t'u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.”*

Në nenin 5, parashikohet se: *“1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njuh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt...”*

Neni 18 , thekson: *“1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit. 2. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij. 3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve. 4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e*

prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.”

Neni 19, parashikon: *“1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. 2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. 3. Ushtrimi i lirisë të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.”*

Neni 20, parashikon: *“1. Çdo propagandë në favor të luftës ndalohet me ligj. 2. Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohet me ligj.”*

Ndërsa Neni 26, parashikon: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtate tjetër.”*

Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, përcakton:

Në nenin 1, se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3, parashikohen përkufizimet, duke parashikuar se:

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirisë themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

.....

8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose

kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”

Në nenin 7, të LMD-së, citohet se: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Akte dhe dokumenta të tjerë të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara, parashtrohen si më poshtë:

- **Rekomandimi nr. R(97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave):**

Termi “gjuhë urrejtjeje” do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësi kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.”

- **Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132):**

Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

....

Organizatave e shoqërisë civile duhet të inkurajohen të krijojnë politika specifike për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes dhe, kur është e përshtatshme dhe e mundshme, të ofrojnë trajnime për stafin, anëtarët dhe vullnetarët e tyre. Organizatat e shoqërisë civile duhet gjithashtu të inkurajohen që të bashkëpunojnë dhe të bashkërendojnë mes tyre dhe me palët e tjera të interesuara për çështjet e gjuhës së urrejtjes.”

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), ka dalë me rekomandimet si më poshtë:

- Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015:

Duke pasur parasysh që, për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së përgjithshme, gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës"1 , ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;

....

Duke pranuar që udhëheqësit politikë, fetarë dhe komunitarë, si dhe personalitete të tjera të jetës publike, kanë një përgjegjësi veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim për shkak të aftësisë për të ndikuar te një publik i gjerë;

B. Përkufizime

Terminologjia

7. Për qëllimet e këtij Rekomandimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a. "avokim" lidhur me denigrimin, urrejtjen apo përgojimin nënkupton mbështetjen e shprehur, të qëllimshme dhe aktive për sjellje dhe qëndrime të tilla lidhur me një grup të caktuar personash;
- g. "denigrim" nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash;
- m. "urrejtje" nënkupton gjendjen mendore të karakterizuar nga emocione të forta dhe joracionale mllëfi, armiqësie dhe përçmimi ndaj grupit të shënjestruar.
- q. "nxitje" nënkupton deklaratat për grupe personash të cilat krijojnë rrezik të menjëhershëm diskriminimi, armiqësie apo dhune ndaj personave të grupit/grupeve;
- u. "stereotipizim negativ" nënkupton një opinion të përgjithshëm sikur një pjesëtar apo pjesëtarët e një grupi personash kanë karakteristika të caktuara, duke i vlerësuar me negativitet, pavarësisht karakteristikave të veçanta të pjesëtarit apo pjesëtarëve fjalë;
- b. "stigmatizim" nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;
- e. "përgojim" nënkupton kritikën abuzive ndaj një apo shumë personave lidhur me anëtarësinë e tyre në një grup të caktuar personash."

- **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike - Komenti i Përgjithshëm nr. 22: Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e dyzet e tetë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993:**

Në përputhje me nenin 20, asnjë manifestim i fesë ose besimit nuk mund të përbëjë propagandë për luftë ose mbrojtje të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë. Siç deklarohet nga Komiteti në komentin e tij të përgjithshëm nr. 11 [19], shtetet palë janë të detyruara të nxjerrin ligje për të ndaluar akte të tilla.

- **Progres Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2023, publikuar në 08.11.2023.¹³ Kapitulli 23, “Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut”:**

Nevojiten politika kombëtare për të drejtuar luftën kundër formave të ndryshme të urrejtjes dhe diskriminimit. Nevojitet zbatim më i mirë dhe ndërgjegjësime më i madh për të eliminuar gjuhën e urrejtjes, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta.

- **Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i gjashtë monitorues), miratuar më 7 prill 2020¹⁴:**

ECRI rekomandon që autoritetet të marrin frymëzim nga rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 15 i ECRI-t për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe të dënojnë me forcë dhe publikisht incidente të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht kundër personave LGBTI dhe romë. Ata gjithashtu duhet të inkurajojnë figura të tjera publike të dënojnë veprime të tilla dhe të përfshihen në kundërpërgjigje.

IV. Analiza ligjore e fakteve dhe provave.

Rezulton se, më 18.05.2023, në televizionin Euronews Albania, është transmetuar emisioni “Good Morning Albanians”, me tematikë “Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për lirinë fetare”. Në këtë emision ishin pjesëmarrës disa përfaqësues të komuniteteve fetare në Shqipëri, ndër ta edhe P. V..

Nga subjekti ankues, është pretenduar se gjatë bisedës së zhvilluar dhe shprehjes së mendimeve nga ana e P. V. janë përdorur deklarata shpifëse dhe me një gjuhë urrejtjeje kundër Shoqatës së DJ dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë.

Pikërisht për sa më lart, subjekti ankues, Shoqata “DJ në Shqipëri”¹⁵, ka paraqitur ankesë kundër P. V., në të cilën pretendohet për diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”, për shkak të

¹³ Faqe 36, e variantit në anglisht të Progres Raportit.

https://neighbourhoodenlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

¹⁴ Faqe 17 e Raportit, në variantin e gjuhës shqipe.

¹⁵ Në vijim referuara edhe si Shoqata.

bindjeve fetare. Ndërsa sa i përket emisionit “Good Morning Albanians”, transmetuar në televizionin Euronews Albania, shoqata theksoi se nuk do ta shqyrtojë në kuadër të kësaj ankese, pasi do ta ndjekë në organe të tjera ligjzbatuese.

Sipas informacionit të dhënë nga subjekti ankues, Shoqata, në emisionin “Good Morning Albanians” të datës 18.05.2023, të transmetuar në televizionin Euronews Albania, i cili kishte si tematikë diskutimi “*Raportin e DASH për lirinë fetare*”, është zhvilluar dialogu i mëposhtëm:

“...P. V.: DJ nuk janë aktivë (në ekran shfaqen pamje të një statusi të bërë prej tij në vitin 2020, me titull: DJ janë një sekt satanik, anti Krisht, dhe gazetari e pyet për këtë status) Ai përgjigjet: Është e vërtetë kjo (i referohet asaj që ka shkruar në status). Unë e shikoj në këtë mënyrë për shkak se DJ janë një sekt ku ka fakte tashmë që për shkak të predikimeve të tyre njerëzit kanë shkuar deri në vetëvrasje. Dhe unë mendoj personalisht që ky është një satanizëm, mund të flasësh çfarë por nëse ti je një njeri i cili nuk i bën gjërat e qarta, nuk mund....shiko kisha apo xhamia nuk është vendi ku lehet? (nuk kuptohet domethënia) Predikimi thikë me dy presa. Duhet qartësuar njerëzit, dhe në qoftë se ti predikon nuk ka ferr po ka parajsë, një njeri i cili ka probleme depresive thotë ‘meqë s’ka ferr unë do ja fus vetes dhe shkoj në parajsë sepse s’ke një vend tjetër ku të shkosh, dhe ky është predikimi i tyre (DJ), për mua është satanik për shkak se s’është e mundur që qenka Zoti s’qenka Djalli..”

Gazetarja: Mund t’ju pyes pak dhe për komunitetin e DJ të gjithëve ju? Ne i kemi kontaktuar sepse donim të kishim përfaqësues të të gjitha besimeve fetare. Si është dhe marrëdhënia juaj me DJ?

P. V.: Kur unë them se është sekt satanik, është për arsye të tilla. Ata janë njerëz shumë të mbyllur, këto janë sekte...(del postimi i tij në ekran) dhe nuk pranojnë të hyjnë në debate, nuk pranojnë të jenë pjesë e tavolinave. Pra janë një sekt, që brenda tyre...ka shtete të cilat i kanë quajtur të jashtëligjshëm.

Gazetarja: DJ?

P. V.: Absolutisht po. Dhe ata janë njerëz që mbjellin urrejtje nëpër shembull, në qoftë se unë në kishën time do predikoj, ti nuk ke të drejtë, ti them besimtarit, që martohet vëllai jot e të mos i shkosh në dasmë, kjo është tmerr...nuk di....

Gazetarja: Pse ku ndodh?

P. V.: Te DJ.

Gazetarja: Po pse?

P. V.: Nuk i lejojnë as t’u shkojnë në festa familjare, as nuk u lejojnë të shkojnë të festojnë ditëlindjet. E pra janë njerëz të cilët... është ...janë kthyer...

Gazetarja: E keni të sigurt këtë? Se mund të jetë dhe ndonjë rast sporadik dhe përgjithësohet.

P. V.: Është predikimi i tyre dhe është 100% një milion % jam i sigurt. Unë e njoh shumë mirë, në qoftë se ka një sekt në Shqipëri që unë e njoh shumë mirë dhe e kam studiuar.

Gazetarja: Juve e quani sekt, vazhdoni ta quani sekt?

P. V.: Është sekt, edhe në Amerikë quhet sekt. Dhe unë... për shembull, do të them se dikush mund të thotë po ata...ti je kundër atyre se ata nuk besojnë se Jezus Krishti është Zot siç beson ti. Nuk është ky thelbi se nëse shkojmë këtu do të merresha me Mormonët, apo do të merresha me

Bahai, por problemi është se është një sekt i rrezikshëm. Dhe unë mendoj shteti shqiptar duhet jo ti persekutojë por duhet ti shikojë këto grupimet që kanë hyrë në Shqipëri.

Gazetarja e pyet a nuk mund t'i përfshini edhe ata mes jush.

P. V.: Unë kam provuar dy herë, kur isha pastor në Berat kam shkuar në shërbesat e tyre kastile sepse e dija cili ishte reagimi i tyre. Gjëja e parë që kanë bërë, më kanë sulmuar, jo me emër, por kanë sulmuar publikisht besimin e krishterë...

Gazetarja e pyet se në çfarë vitesh bëhet fjalë dhe çfarë kanë thënë.

P. V.: 93-94 s'ka rëndësi çfarë kanë thënë por e kam fjalën në qoftë se...këto janë sekte të cilat shteti duhet të merret seriozisht.

Gazetarja: Po mund të kenë ndryshuar...

P. V.: Jo nuk kanë ndryshuar sepse e kanë...ata kanë Kullën e Rojës, një revistë e cila i instruktin ata në mënyrë të detajuar cila është mënyra e sjelljes, mënyra e jetesës dhe mënyra e sjelljes me ata që janë jashtë grupimit të tyre”.

Për sa më sipër, Shoqata “DJ” konsideron se në dialogun e transkriptuar më lart, është përdorur gjuhë urrejtjeje dhe diskriminuese e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë komunitetin e tyre fetar, duke u shprehur se:

“P. V. i përshkroi DJ si një “sekt të rrezikshëm”, “satanik”, shtrembëroi bindjet dhe praktikat tona dhe shkoi deri aty sa akuzoi në mënyrë të rreme DJ për krime serioze si nxitje të vetëvrasjes dhe nxitje të urrejtjes. Komentet e tij janë plot me një gjuhë urrejtjeje, shpifëse, diskriminuese dhe shërbejnë veçse për të ushqyer urrejtje, mosbesim dhe dyshime ndaj minoritetit tonë fetar.”

Lidhur me disponimin e videos së emisionit apo linkut zyrtar të televizionit Euronews Albania, Komisioneri ka kërkuar nga Euronews Albania që një kopje e tij, t'i vihet në dispozicion, në funksion të procesit hetimor të ankesës në fjalë.

Euronews Albania, si autoriteti që mban autorësinë e sa më sipër, nëpërmjet shkresës datë 02.08.2023 ka vendosur në dispozicion të KMD-së, një kopje të CD-së së emisionit të plotë “Good Morning Albanians”, të datës 18.05.2023. Gjithashtu, Komisioneri arriti të administrojë edhe linkun e këtij emisioni: <https://www.youtube.com/watch?v=FFsgIKsHIVE>

Në rastin konkret, institucioni i Komisionerit ka zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara jo vetëm në ligjin e tij rregullator, por dhe detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, pavarësisht se, referuar nenit 78¹⁶, të tij, materiale të tilla, lejohen të riprodhohen pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative.

¹⁶ “Përdorimi i veprave për procedura gjyqësore, administrative dhe procedura të tjera zyrtare” parashikon se: “Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”.

Lidhur me shprehjet dhe gjuhën e përdorur nga P. V..

Në mediat shqiptare, jo në pak raste, është konstatuar se kultura e fjalës së përdorur nuk është e duhura. Njëkohësisht, është vënë re jo në pak raste jemi ndeshur me fenomenin e nxitjes, përdorimit dhe përhapjes së “gjuhës së urrejtjes” në publik për kategori apo grupe shoqërore, pa reflektuar asnjë ndjenjë përgjegjësie për fjalën e thënë në median e shkruar dhe atë televizive.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet minimale të saj rezultojnë të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t'i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjislacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkelura.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme.

Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

KEDNJ është forma më e rëndësishme e shprehjes së angazhimit të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për vlerat e demokracisë, paqes dhe drejtësisë dhe nëpërmjet tyre, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve që jetojnë në këto shoqëri. Kjo Konventë përmban parashikime të rëndësishme mbi lirinë e shprehjes, ku përveç mbrojtjes që i siguron kësaj të drejte, përcakton edhe kufizimet përkatëse.

Në nenin 9, KEDNJ, parashikon se: *“Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë”, citohet se: “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.”*

Në Nenin 10, të KEDNJ-së parashikohet shprehimisht:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të

transmetimit kinematografike ose televizive.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”

Në paragrafin e parë të këtij neni përkufizohen të drejtat e mbrojtura, ndërkohë që në paragrafin e dytë të tij, përcaktohen rrethanat në të cilat një shtet në mënyrë të legjitimuar mund të ndërhyjë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes. Për më tepër, neni 10 i KEDNJ-së, mbron jo vetëm përmbajtjen e informacionit dhe ideve, por edhe formën në të cilën janë shprehur ato. Kështu, dokumentet e shkruara, transmetimet në radio dhe televizione, pikturat, filmat, apo edhe sistemet e informacionit elektronik janë gjithashtu të mbrojtura sipas këtij neni. Për pasojë, mjetet e prodhimit dhe komunikimit, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit dhe ideve mbulohen gjithashtu nga neni 10, i KEDNJ dhe institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gjykatat duhet të jenë të ndërgjegjshëm për zhvillimet e shpejta teknologjike dhe mënyrës së si liria e shprehjes mund të ndahet nëpërmjet mënyrave të tilla.

Mbështetur në paragrafin 2, të nenit 10 të KEDNJ-së, autoritetet vendase në çdonjërin nga Shtetet Kontraktues mund të ndërhyjnë me ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 (tre) kushte së bashku¹⁷:

1. Ndërhyrja (në kuptimin e “formalitetit”, “kushtit” ose “sanksionit”) parashikohet me ligj;
2. Ndërhyrja ka si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar; integritetin territorial; sigurinë publike; ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit; mbrojtjen e shëndetit; moralit; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; ndalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë, dhe garantimin e autoritetit të paanshmërisë së gjyqësorit;
3. Ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “*nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....*”¹⁸.

Më tej, Gjykata ka garantuar lirinë e medias duke u shprehur në mënyrë të përsëritur se: “*...kërkesa e përgjithshme që gazetarët të distancohen sistematikisht dhe formalisht nga përmbajtja e një citimi që mund të çojë në fyerje apo provokim të të tjerëve, apo të dëmtojë*

¹⁷ Carss-Frisk, M., Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane - Liria e Shprehjes;

¹⁸ *Engels and Others kundër Hollandës*, 1976.

reputacionin e tyre nuk pajtohet me rolin e shtypit për të ofruar informacion mbi çështjet e ditës, opinionet dhe idetë.”¹⁹

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet shprehimisht: “*Liria e shprehjes është e garantuar.*”

Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike.

Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinioneve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin shprehjen/dhënie dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdolloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e shprehjes është objekt i kufizimeve sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2 si dhe neni 17 të saj.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij të marra së bashku me nenin 20/2.

Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), kufizimet e vendosura nga neni 10/2 i KEDNJ, zbatohen jo vetëm për 'informacionet' ose 'idetë' që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jo fyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance dhe mendje gjerësie pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo 'formalitet', 'kusht', 'kufizim' ose 'dënim' i vendosur në këtë sferë duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur”. (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 7 dhjetor 1976, paragrafi 49*).

¹⁹ Thoma kundër Luksemburgut,/64; Albert-Engelmann-Gesellschaft mbH kundër Austrisë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë edhe gjininë, ndalon çdo formë të shprehjes në publik, me çdo mjet, të promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes për këto shkaqe. Këto shprehje, përbëjnë “gjuhë urrejtje”, e cila sipas ligjit përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve a grupeve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike.

Lidhur me pretendimin e subjektit ankues për përdorim të gjuhës së urrejtjes nga ana e P. V., në emisionin “Good Morning Albanians”, të datës 18.05.2023, Komisioneri ka analizuar regjistrimet e vëna në dispozicion përmes CD-së nga autoriteti përkatës që mban dhe autorësinë e këtij materiali, televizioni Euronews Albania.

Përsa më sipër, Komisioneri saktëson se, ka analizuar shprehjet e gjuhën e përdorur nga P. V., referuar dialogut më lart, të cilat i ka vlerësuar *se potencialisht kishin premisa për një gjuhë që shkon në tejkalim të lirisë së shprehjes*.

Në kontekst të shprehjeve e gjuhës së përdorur në pasazhin, dialogun sipërcituar, si dhe qëndrimin e P. V.²⁰, Komisioneri, thekson se:

²⁰“.... DJ janë një sekt satanik, anti Krisht, dhe gazetari e pyet për këtë status...

DJ janë një sekt ku ka fakte tashmë që për shkak të predikimeve të tyre njerëzit kanë shkuar deri në vetëvrasje. Dhe unë mendoj personalisht që ky është një satanizëm...

Duhen qartësuar njerëzit, dhe në qoftë se ti predikon nuk ka ferr po ka parajsë, një njeri i cili ka probleme depresive thotë ‘meqë s’ka ferr unë do ja fus vetes dhe shkoj në parajsë sepse s’ke një vend tjetër ku të shkosh, dhe ky është predikimi i tyre (DJ), për mua është satanik për shkak se s’është e mundur që qenka Zoti s’qenka Djalli...

Kur unë them se është sekt satanik, është për arsye të tilla. Ata janë njerëz shumë të mbyllur, këto janë sekte...(del postimi i tij në ekran) dhe nuk pranojnë të hyjnë në debate, nuk pranojnë të jenë pjesë e tavolinave. Pra janë një sekt, që brenda tyre...ka shtete të cilat i kanë quajtur të jashtëligjshëm...

Së pari, shprehjet dhe gjuha e përdorur gjatë emisionit nga P. V., janë analizuar duke i kushtuar një rëndësi të veçantë faktit që janë përdorur në një televizion privat kombëtar si Euronews Albania, në një orar dhe në kushtet kur shikueshmëria e këtij emisioni nga publiku është e konsiderueshme.

Po ashtu, duke patur në konsideratë edhe faktin se, emisioni në fjalë ishte publik dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen youtube²¹, duke bërë të mundur që jehona e shprehjeve të përdorura të ketë një përhapje të gjerë në opinionin publik.

Së dyti, duke patur në konsideratë, personalitetin e figurën e P. V., si një person publik, në cilësinë e Pastorit të Kishës Evangjeliste në Shqipëri, i cili për këtë shkak është i ftuar i përhershëm në televizione e media të tjera, për të analizuar e shprehur opinione për ngjarje të ndryshme shoqërore, fetare, etj., si dhe faktin që P. V. mban në përditshmëri shërbesat e fetare në Kishën Evangjeliste apo on-line, në rrjetet e tij sociale²², i cili ndiqet nga më shumë se 50.000 persona (pranuar nga P. V. gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së), padiskutim, figura dhe fjala e tij është me ndikim dhe impakt të gjerë në publik.

Duke ju referuar përmbajtjes së diskutimeve, P. V., ndër të tjera, në fjalën e tij thekson se DJ janë një sekt satanik, i rrezikshëm, anti Krisht dhe për shkak të predikimeve të tyre ata kanë shkuar deri në vetëvrasje. Në këtë kuptim, Shoqata “DJ” dhe komuniteti fetar që ata përfaqësojnë, portretizohen si persona të cilët paraqesin rrezik për besimtarët e tyre dhe shoqërinë në tërësi.

Në analizën që KMD i ka bërë gjuhës së përdorur në këtë emision nga P. V., ka vlerësuar se përdorimi i saj konsiderohet në tejkalim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kontekst, KMD, në analizën e tij, i është referuar kufizimeve që parashikon KEDNJ për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10, të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar në gjykime të ndryshme se:

Absolutisht po. Dhe ata janë njerëz që mbjellin urrejtje në ...për shembull, në qoftë se unë në kishën time do predikoj, ti nuk ke të drejtë, ti them besimtarit, që martohet vëllai jot e të mos i shkosh në dasmë, kjo është tmerr...nuk di...

...Është sekt, edhe në Amerikë quhet sekt...

...por problemi është se është një sekt i rrezikshëm...”.

²¹ <https://www.youtube.com/watch?v=FFsgIKsHIVE>

²² <https://www.facebook.com/p.v.>

https://www.instagram.com/p_v/

“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.

Përveç sa më sipër, KMD gjykon se për rastin konkret është me vend të përmendet edhe Rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, 8 Dhjetor 2015, i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, i cili është një akt shumë i rëndësishëm, që u drejtohet qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës dhe që fokusohet në fenomenin e gjuhës së urrejtjes dhe pasojat e dëmshme të përdorimit të saj për individët, grupe të caktuara personash dhe shoqërinë në tërësi.

Gjuha e urrejtjes për qëllimin e Rekomandimit nënkupton përdorimin e një ose më shumë formave të veçanta të shprehjes - përkatësisht, avokimin, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes - që bazohet në një listë joshtruese të karakteristikave personale apo statusit që përfshin racën, ngjyrën, gjuhën, *fenë ose besimin*, kombësinë ose prejardhjen kombëtare apo etnike, si dhe prejardhjen prindërore, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, gjininë, identitetin gjinor dhe orientimin seksual.

Në këtë Rekomandim, elementët domethënës të konceptit “gjuhë urrejtje”, lidhen me:

- promovimin apo nxitjen e çfarëdo forme denigrimi, urrejtjeje apo përgojimi, si edhe ngacmimin, fyerjen, stereotipizimin negativ, stigmatizimin apo kërcënimin;
- përdorimin që synon jo thjesht të nxitë kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, por edhe pritshmërinë e arsyeshme që ky përdorim të ketë këto efekte; dhe;
- shkaqet që shkojnë përtej racës, ngjyrës, gjuhës, fesë apo besimit, kombësisë, prejardhjes kombëtare apo etnike apo prejardhjes prindërore.

“Shprehja” sipas këtij Rekomandimi përfshin fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias të çdo forme, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video. Ndërkohë që, format e shprehjes që janë në fushën e veprimit të Rekomandimit mund të përfshijnë edhe mohimin publik, banalizimin, justifikimin apo legjitimimin për krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit ose krimet e luftës, të cilat janë konstatuar nga gjykatat, si edhe lartësimin e personave për kryerjen e krimeve të tilla.

Nëpërmjet këtij Rekomandimi, ndër të tjera, shteteve palë u rekomandohet që “të ofrojnë mbështetje individuale dhe kolektive për personat e shënjestruar nga gjuha e urrejtjes ...”²³ si dhe “të përdorin fuqitë rregullatore në drejtim të medias (përfshirë ofruarit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit online dhe median sociale) që të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të kontestojnë natyrën e papranueshme të saj, duke u siguruar njëkohësisht që masa të tilla të mos përbëjnë shkelje të lirisë së shprehjes dhe mendimit...”²⁴ nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve të caktuara në këtë akt.

Praktika e GJEDNJ-së, gjithashtu, është e pasur lidhur me vendimmarrjet mbi çështjet, ku objekt gjykimi ka qenë gjuha e urrejtjes. Në çështjet Féret k. Belgjikës, (2007) dhe Vejdeland dhe të tjerë k. Suedisë, (2012), GJEDNJ ka pranuar se nxitja e urrejtjes mund të rezultojë në fyerje, tallje apo shpifje ndaj grupeve të caktuara të popullsisë, kur këto forma të shprehjes ushtrohen në mënyrë të papërgjegjshme, që nënkupton se është fyese në mënyrë të panevojshme, avokon diskriminimin apo përdor gjuhë cenuese apo poshtëruese ose i imponohet publikut në mënyrë të pashmangshme dhe këto forma janë brenda fushës së veprimit të përkufizimit të Rekomandimit të sipërcituar.

Në çështjen Garaudy kundër Francës, (2003), GJEDNJ u mbështet në nenin 17 të KEDNJ-së dhe u shpreh se liria e shprehjes nuk mund të përdoret për të çuar në shkatërrimin e të drejtave dhe lirive të tjera, të garantuara nga Konventa. Këto vendime zbatojnë teorinë e paradoksit të tolerancës: një tolerancë absolute mund të çojë në tolerancën e ideve që nxisin mostolerancë dhe kjo e fundit mund të asgjësojë tolerancën²⁵.

Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, në pikën 9 të tij, citon ndër të tjera se: “Vitet e fundit, gjuha e urrejtjes është përhapur gjithnjë e më shumë përmes internetit. Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes në internet paraqet sfida specifike, pasi ajo mund të shpërndahet si kurrë më parë në të gjithë botën brenda pak sekondash. Ndonjëherë mund të mbetet vazhdimisht i disponueshëm në internet (shih Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata), Delfi AS kundër Estonisë, nr. 64569/09, 16 qershor 2015 [Dhoma e Madhe], § 110; dhe Annen kundër Gjermanisë, nr. 3690/10, 26 nëntor 2015, § 67). Shtetet anëtare kanë detyrimin për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore edhe në mjedisin digjital (§ 1.1.3 i CM/Rec(2018)2 mbi rolet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësve të internetit). Kjo përfshin detyrën për të mbrojtur individët kundër shkeljeve, përfshirë shkeljet e mundshme, të kryera nga persona të tjerë privatë dhe organizatat (Platforma “Ärzte für das Leben” kundër Austrisë, nr. 10126/82, 21 qershor 1988, §§ 32 e në vazhdim”.

²³ Referuar pikës 5 të Rekomandimit të Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhes së Urrejtjes (2015)

²⁴ Referuar pikës 7 të Rekomandimit të Politikave të Përgjithshme Nr. 15 për Luftimin e Gjuhes së Urrejtjes (2015)

²⁵ Siniarska D.B, (2015) Manual për praktikantët e ligjit - Mbrojtja e së drejtës për lirinë e shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, faqja 12, paragrafi 1;

GJEDNJ ka trajtuar jo vetëm rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga subjekte të caktuara, por edhe rastet kur nga subjekte të tjera në lidhura me ta, nuk është mbajtur qëndrim kritik ndaj përdorimit të kësaj gjuhe. Kështu, në çështjen *Erbakan kundër Turqisë*, 6 korrik 2006, GJEDNJ është shprehur se, në parim, mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. Në çështjen *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar 1976*, GJEDNJ është shprehur se e drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, tronditë apo shqetësojë” të tjerët.

Në çështjen *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë*, GJEDNJ-ja mban qëndrimin se, në disa raste ndërhyrja në lirinë e shprehjes është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve.

Për të vlerësuar nëse ekziston rreziku që aktet e promovuara ose të nxitura nga gjuha e urrejtjes të ndodhin, Komisioneri ka marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, në përputhje me frymën e Rekomandimit Nr. 15 të ECRI-t.

Debati dhe diskutimi për çështje të ndryshme është i nevojshëm veçanërisht për tema apo çështje sensitive, që janë në interes të opinionit të gjerë. Diskutime mbi informacione jo të bazuara shpesh çojnë në krijimin e paragjykimeve dhe stigmatizimin e personave për shkak të besimit apo bindjeve fetare. Ligjërime apo fjalime të tilla, të cilat i portretizojnë Shoqatën “DJ” dhe komunitetin fetar që ata përfaqësojnë, si “sekt satanik, të rrezikshëm, të cilët kanë çuar besimtarët e tyre në vetëvrasje”, në rastin konkret, stimulojnë frikën, nxisin qëndrime negative, nxisin diskriminimin dhe për këtë arsye ato janë në kundërshtim me ligjin. Gjuha e përdorur nga P. V. etiketon Shoqatën “DJ” dhe komunitetin fetar që ata përfaqësojnë, në një mënyrë të gabuar, duke i vendosur ata në pozita paragjyquese, duke i stereotipizuar, duke keqinformuar publikun, gjë e cila mund të passjellë edhe viktimizim të tyre.

Gjuha e përdorur nga P. V., është përcjellë në një kontekst të një debati të lindur si pasojë e diskutimit të një tematike krejtësisht tjetër, atë të Raportit të DASH për lirinë fetare. Komisioneri thekson se gjuha e përdorur mund të nxisë komente nga persona të ndryshëm në platformat sociale si “Youtube”, “Facebook”, etj, komente të cilat mund të jenë fyese, paragjyquese, denigruese dhe krejtësisht të papërshtatshme.

Duke qenë një Pastor i njohur dhe mbrojtës i shumë kauzave në shoqëri, P. V., ka aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë. Në mënyrë të veçantë rezultojnë se P. V., është person shumë aktiv në jetën publike nëpërmjet prezencës së tij në media. Duke u bazuar tek statusi i tij, ai mbart detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet e

ndryshme. Pavarësisht qëllimit, perceptimi që shkon tek publiku mund të jetë krejt ndryshe, sidomos kur ata portretizohen negativisht.

Komisioneri gjykon se nuk është e gabuar të informohet publiku dhe të diskutohen tema sensitive që prekin grupe të ndryshme vulnerabël, por veshja dhe referimi i mendimeve apo perceptimeve personale, sidomos me konotacion negativ, përbën një qëndrim të gabuar dhe krijon premisa për paragjykime si dhe stereotipe negative. Në këtë kuptim, referimi i P. V., cituar më lart në këtë vendim, përbën një qëndrim jo profesional, jo informues, paragjykes dhe nga ana tjetër krijon negativitet kundrejt një grupi specifik shoqëror që janë besimtarët e DJ duke i shqetësuar ato dhe duke krijuar premisa për sjellje diskriminuese kundrejt tyre.

Në çështjen *Norwood kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2004), aplikanti, një organizator rajonal i Partisë Kombëtare Britanike vendosi në dritaren e apartamentit të tij një poster që paraqiste Kullat Binjake në flakë, me fjalët “*Islami jashtë Britanisë – Mbroni popullin britanik*” dhe simbolin e gjysmëhënës dhe yllit brenda shenjës së ndalesës. Gjykatat e vendit e dënuan aplikantin për shkelje të rendit publik dhe Gjykata Evropiane u pajtua me këtë vendim, duke argumentuar se dënimi i Norwood nuk shkelte Nenin 10 pasi “*fjalët dhe imazhet në poster përbënin shprehje publike të sulmit kundër të gjithë myslimanëve në Mbretërinë e Bashkuar*”. Një sulm i tillë i përgjithshëm, i ashpër kundër një grupi fetar, që e lidh grupin fetar në tërësi me një akt të rëndë terrorizmi, nuk është në përputhje me vlerat e shpallura dhe të garantuara nga Konventa, përkatësisht toleranca, paqja shoqërore dhe mosdiskriminimi²⁶.

Në çështjen *Sanchez v. France* (*Application no. 45581/15*, 15.05.2023), aplikanti, një politikan i zgjedhur, nuk kishte filtruar/fshirë në faqen e administruar prej tij në Facebook, mesazhet islamofobike të postuara nga palë të treta, ndjekës të tij në rrjetin social. Lidhur me këtë Gjykatat e vendit e dënuan penalisht politikanin, me arsyetimin se nuk kishte marrë masa për të fshirë dhe filtruar mesazhet e postuara në faqen e tij në Facebook, ku palë të treta përmes komenteve bënin thirrje islamofobike. GJEDNJ konstatoi se vendimet e gjykatave vendase janë bazuar në arsye të mjaftueshme, si përsa i përket përgjegjësisë që i atribuohet kërkuesit, në cilësinë e tij si politikan, për komentet e paligjshme të postuara në prag të zgjedhjeve në "murin" e tij në Facebook nga palë të treta, të cilët u identifikuan dhe u ndoqën penalisht si bashkëpunëtorë me të²⁷.

Në çështjen *Centre of Societies for Krishna Consciousness in Russia And Frolov V. Russia* (*Application no. 37477/11*, 23/02/2022), Gjykata Evropiane e dënoi Rusinë për përhapjen e një broshure të një organizate antisekt, e cila kishte përdorur shprehje armiqësore ose ide të përcjella si kult totalitar shkatërrimtar për shoqërinë ruse, që praktikojnë manipulim psikologjik. Gjykata vlerësoi se, edhe kur masat e marra nga qeveria nuk e kufizuan lirinë e kërkuesve për të shfaqur besimet e tyre nëpërmjet adhurimit dhe praktikës, termat armiqësore që autoritetet shtetërore përdorën për të përshkruar lëvizjen e tyre mund të kenë pasur pasoja negative për ta dhe përbëjnë një ndërhyrje në të drejtat e tyre, sipas nenit 9 § 1 të Konventës. Në rastin konkret, një botim nga

²⁶ Shih <https://tinyurl.com/ue88dkn7>

²⁷ <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22001-224928%22%5D%7D> /përkthim i KMD

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

autoritetet shtetërore rajonale e përfaqësonte Shoqërinë e Krishna-s si një "kult totalitar" "shkatërrues" "lakmitar parash për shoqërinë ruse", dhe gjithashtu e akuzoi atë për "manipulim psikologjik" dhe "zombizim" të të rinjve. Publikimi iu shpërnda edukatorëve për përhapje të mëtejshme mes nxënësve të tyre dhe u vu gjithashtu në dispozicion për shkarkim nga faqja e internetit e qeverisë rajonale. Prandaj, Gjykata konstatoi se, duke përdorur gjuhë nënçmuese dhe pretendime të pabazuara për të përshkruar bindjet fetare të kërkuese dhe mënyrat në të cilat ato shprehen, autoritetet ruse kanë tejkaluar kufirin e tyre të vlerësimit. Gjykata vlerësoi gjithashtu se ankesa për trajtimin diskriminues, për të cilën qendra kërkuese pretendonte se ishte viktimë, është marrë parasysh në vlerësimin e mësipërm që çoi në konstatimin e shkeljes së nenit 9²⁸. Për këtë e dënoi Rusinë për përhapjen e një broshure të një organizate "anti sekt" e cila kishte përdorur "shprehje armiqësore" ose ide të përcjella si "kult totalitar", "shkatërrimtar për shoqërinë ruse", që praktikojnë "manipulim psikologjik" për të etiketuar një numër minoritetesh fetare, përfshirë DJ. (*Shiko gjithashtu Christian Religious Organization of J. 's Witnesses in the NKR i'. Armenia, nr. 41817/10, § 9, 16, 72, 74, 22 March 2022; Taganrog LRO and Others v. Russia, nr. 32401/10 dhe 19 të tjerë, § 157, 161-183, 7 qershor 2022; dhe Tonchev and Others v. Bulgaria, nr. 56862/15, § 61, 62, 13 dhjetor 2022.*)

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh edhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur deklaratat. Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet medias audiovizive apo mediave sociale nëpërmjet internetit, janë shumë më e fuqishme dhe arrin te një publik shumë të gjerë. Mediat sociale apo interneti, siç është cituar edhe në Rekomandimin CM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, kanë një mundësi shpërndarje si kurrë më parë në të gjithë botën brenda pak sekondash.

Komisioneri vlerëson se, gjuha e përdorur nga P. V., krijon në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj Shoqatës "DJ" dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë. Në çështjen Féret kundër Belgjikës²⁹, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: ".....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirëinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje

Edhe pse deklaratat e bëra nga P. V., nuk drejtohen kundër individëve të caktuar, besimtarët e DJ në Shqipëri, portretizohen dhe etiketohen si modele negative vetëm për shkak të besimit apo bindjeve të tyre fetare. Këto deklarata edhe pse nuk janë një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptohen si deklarata që nxisin urrejtje. Pavarësisht qëllimit për të cilin janë thënë dhe pavarësisht se nuk i janë drejtuar një personi të caktuar, mënyra se si manifestohet një mendim i P. V., të cilat portretizojnë negativisht një grup shoqëror, perceptohet dhe portretizon Shoqatën "DJ" dhe komunitetin fetar që ata përfaqësojnë, negativisht.

²⁸ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%2237477/11%22%5D%22itemid%22:%5B%22001-213367%22%5D%22%7D>
/përkthim i KMD

²⁹ Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009

Komisioneri thekson se, Shoqata “DJ” dhe komuniteti fetar që ata përfaqësojnë janë portretizuar dhe etiketuar si modele negative edhe në të shkuarën, kur në muajin Korrik të vitit 2020, 2 (dy) anëtare të një familje u gjetën pa jetë në banesën e tyre, në zonën e ish Kombinatit në Tiranë, duke u evidentuar si pjesë e Shoqatës së “DJ”. Për shkak të dezinformimit mediatic dhe informacioneve të pavërteta kjo shoqatë dhe besimtarët e saj u etiketuan në mënyrë negative duke u stereotipizuar dhe stigmatizuar në opinionin publik.

Duke ju rikthyer çështjes Féret kundër Belgjikës, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: “.....ndonëse deklaratat e ankuesit nuk drejtoheshin kundër individëve të caktuar – anëtarë të komuniteteve të emigrantëve/refugjatëve, ata i shihnin ata kolektivisht nën një dritë negative dhe i portretizonin si kontingjent krimi dhe oportunist të prirur për të përfituar nga rezidenca e tyre në Belgjikë”.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e Firmës Feryn (*Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër Firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008*), ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet një viktimë. Komisioneri vlerëson se në çështjen në fjalë, gjuha e përdorur përcjell një gjuhë urrejtje të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese, do të cënonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 8 parashikon se: “*Gjuha e urrejtjes*” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”.

Siç vërehet, në nenin e sipërcituar referohet “...çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet...”, çka do të thotë që në kuptim të ligjit çdo mënyrë publike e të shprehurit që krijon premisën e parashikuar në këtë formë diskriminimi është dhe duhet hetuar. Aq e vërtetë është kjo sa është praktikë e gjerë e GJEDNJ që të hetojë dhe të shprehet edhe në rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes me mjete tjera jo tradicionale si rrjete sociale, portale on line apo edhe komente nga përdoruesit.

Për këtë qëllim sjellim në vëmendje standardet e Këshillit të Evropës në lidhje me gjuhën e urrejtjes, nëpërmjet Rekomandimit nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “*Për luftimin e gjuhës së urrejtjes*”³⁰ (materiali në link), në bazë të cilit është mbështetur edhe legjislatori shqiptar në përkufizimin e kësaj forme diskriminimi në Ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Po ashtu, edhe jurisprudencën dhe vendime konkrete të

³⁰ <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

GJEDNJ-së në lidhje me format dhe mjetet e shprehura të gjuhës së urrejtjes dhe kuptimit të saj nga kjo gjykatë.³¹

Në frymë të këtij rekomandimi dhe jurisprudencës së sipërcituar, shqetësimi lidhet me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, pavarësisht nga mjeti i përdorur. Sidomos në rastet kur personi i prezumuar që ka përdorur gjuhë urrejtje e ka bërë këtë me zë dhe me figurë, i identifikuar me emër dhe mbiemër, në media me shtrirje kombëtare, ku është aksesuar nga çdo njeri dhe shpërndarë³² nga media të tjera on-line.

Në përfundim, në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, rëndësi ka që përdorimi dhe emetimi i saj, pavarësisht mjetit të përdorur, ka ndodhur ose/dhe vazhdon të ndodhë dhe krijon shqetësim në shoqëri e akoma më tepër në grupe shoqërore të konsideruara pakica dhe të njohura si sistematikisht të diskriminuara.

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjuha e përdorur nga P. V., përbën gjuhë urrejtje kundër Shoqatës së “DJ” dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë, për shkak të bindjeve fetare. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej tij, janë në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojë mbrojtje nga nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenet 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neneve 18 dhe 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsytet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional.

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ligji nuk ka

³¹ Çështja Jersild kundër Denimarkës 23 Shtator 1994 – Fragmente nga dokumentar;

Çështja Gündüz kundër Turqisë 4 Dhjetor 2003 – Debat televiziv;

Çështja Erbakan kundër Turqisë 6 Korrik 2006 – Fjalim publik;

Çështja Pavel Ivanov kundër Ruisë 20 Shkurt 2007 – Artikull i shkruar;

Çështja Féret kundër Belgjikës 16 July 2009 – Fletëpalosje;

Çështja Delfi AS kundër Estonisë 16 Qershor 2015 – Koment në një portal në internet;

Çështja Belkacem kundër Belgjikës 27 June 2017 – Komentë në Youtube;

Çështja Šimonić kundër Kroacisë 22 Janar 2019 – mesazhe në një ndeshje futbolli;

Çështja Beizaras dhe Levickas kundër Lithuanisë 14 January 2020 – Komentë në Facebook;

Çështja Lilliendahl kundër Islandës 12 Maj 2020 – Komentë në një artikull on line;

Çështja Zemmour v. France 20 dhjetor 2022 – Deklaratë në emision televiziv;

Çështja Valaitis kundër Lithuanisë 17 January 2023 – Komentë në internet

³² <https://www.youtube.com/watch?v=Odyar9-AhIQ>

<https://lajmifundit.al/aktualitet/sekt-satanik-pastori-kunder-dj-shume-shtete-i-k-i-1229521>

https://www.facebook.com/SHOIPERIA.IME.2010/posts/618221050342474/?paipv=0&eav=AfYem63MRQfJotUyXjS3NZrud9AniEkvcs38o_wq1wpyKIJ8_IQ5fs5DMMarsXXs05Q&_rdr

<https://liberale.al/pastori-kunder-dj-eshte-sekt-satanik-shume-shtete-e-kane-shpallur-te-jashteligjshem/>

përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë detyrimi i P. V., që të bëj një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër Shoqatës “DJ” dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë, si dhe të evitohet në të ardhmen përdorimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të Shoqatës “DJ” dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë, për shkak të bindjeve fetare nga P. V., në emisionin “Good Morning Albanians”, mbajtur më datë 18.05.2023, në televizionin Euronews Albania.
2. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, P. V., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëj një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër Shoqatës “DJ” dhe komunitetit fetar që ata përfaqësojnë, si dhe të evitohet në të ardhmen përdorimin e saj.
3. Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, Televizioni Euronews Albania³³, rekomandohet të marrë masa të menjëhershme për eliminimin/mbulimin e shprehjeve diskriminuese të përdorura nga P. V. në emisionin “*Good Morning Albanians*” të transmetuar më datë 18 maj 2023 apo pjesëve të shkurtuara të publikuara në faqen www.youtube.com apo rrjete të tjera sociale të cilat i administron, brenda 5 (pesë) diteve nga marrja dijani mbi këtë vendim.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, P. V., duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

³³ Shoqëria “Euro Balkans News” sh.p.k.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodë Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet fetare)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)